




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-25-6135-2-1-1/C1071
14 Nr. 915/25
Dt. 25.08.2025

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi - Zyrtar Përgjegjës për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **POROSITËSI**) , dhe
2. " Hashim Miftari B.I "emri i biznesit/ N.SH.T. " Blendi Reisen " me seli në Vushtrri, si operatorë ekonomik, me ARBK: 810683377, të cilën e përfaqëson z. Hashim Miftari, në tekstin e mëtejme **KRYESI I SHËRBIMIT**

Lënda e kontratës: Llot:36 - Transporti i nxënësve në relacionin: nga fshati Dumnice e Epërme (te stacioni i autobusit) lagja Bala, SHFMU „Bajram Curri" në fshatin Dumnice e Mesme dhe anasjelltas

(42 nxënës x 62.00€ për ditë pune)
(42 nxënës ndërrimi i para ditës dhe asnjë nxënës ndërrimi i pas ditës)

Neni 1.

- 1.1. Porositësi me rastin e përpilimit të kësaj kontrate i ofron punë Shërbyesit që ky i fundit të ofroj shërbime të transportit të nxënësve të cilat duhen të jenë në harmoni të plotë me kushtet dhe kriteret teknike të specifikuara si në dokumentacionin standard të Dosjes së tenderit me nr. të ref. VU644 - 25 - 039 - 211.
- 1.2. Transporti i nxënësve në relacionin shtëpi - shkollë - shtëpi, si në titullin e lëndës të kësaj kontrate, do të bëhet nga data: 01.09.2025 dhe do të zgjasë deri më datë 30.06.2026 për muajt: Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2025 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2026 në ditët që sipas Plan Programit mësimor zhvillohet procesi mësimor, respektivisht deri më datën të cilën e saktëson Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 2.

- 2.1. Çmimi i kontratës është për njësi, ditë pune/shërbimi brenda një muaji kalendarik, dhe ka vlerën prej **62.00€/ditë pune**, që paraqet çmimin e një ditë pune, të cilën Autoritetit Kontraktues duhet t'ia paguaj Kryesit të Shërbimeve në bazë të Raportit mbi konfirmimin e ekzekutimit të shërbimeve mujore të hartuar nga Menaxheri i kontratës i A.K.. Vlera e përgjithshme e kontrates per 10 muaj eshte **11,470.00 €**.

Neni 3.

- 3.1. Kryesi i Shërbimeve merr për obligim që realizimi i kësaj kontrate të zbatohet në përpikëri, duke përdorur pajisjet teknike të dëshmuara në dosjen e tenderit gjatë procesit të aplikimit. Mjetet e transportit duhen të jenë gjithëherë në gjendje teknike të rregullt dhe të drejtohen nga personi i kualifikuar.
- 3.2. Po ashtu Kryesi i Shërbimeve siguron Autoritetin Kontraktues se, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me transport të veçantë të udhëtarëve dhe në bazë të lejes së veçantë, në këtë rast të nxënësve, Kryesi i Shërbimeve, gjatë transportit të nxënësve do të

përfundim të orarit të mësimi në të njëjtën mënyrë ti marrë nga shkolla dhe ti dërgoi në vendin e caktuar, duke u kujdesur gjithmonë për konformitetin e transportit dhe sigurinë e nxënësve, marrë parasysh moshën e tyre të re.

- 3.3. Gjithashtu, Kryesi i Shërbimeve, siguron Autoritetin Kontraktues se do të përmbushë me përpikëri obligimin e tij që nxënësit me kohë, si në ndërrimin e para ditës ashtu edhe në ndërrimin e pas ditës, t'i marrë në vendin e caktuar nga Njësia e Kërkesës, t'i dërgoi me kohë në shkollë dhe pas përfundimit të orarit të mësimi në të njëjtën mënyrë ti marrë nga shkolla dhe ti dërgoi në vendin e caktuar, duke u kujdesur gjithmonë për konformitetin e transportit dhe sigurinë e nxënësve, marrë parasysh moshën e tyre të re.

Neni 4.

- 4.1. Në rast se Shërbyesi dështon në përmbushjen e detyrimit si në nenin një të kësaj kontrate, Porositësi mbanë të drejtën ta anuloi kontratën pa pasur ndonjë obligim ndaj Shërbyesit ose për secilën ditë në vonesë të Shërbyesit të zbatoi penale mbi baza ditore në masën 0,25% të vlerës së kontratës për shërbime të pa përfunduara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës, në çdo ditë të vonesës.

Neni 5.

- 5.1. Kryesi i shërbimit do t'i ofroi nxënësit shërbime të mira të transportit që kanë përmbajtjen dhe veçorinë e parashikuar me këtë kontratë dhe të kujdeset për të drejtat dhe interesat e nxënësit, në pajtim me praktikën e mirë në këtë sferë.
- 5.2. Kryesi i shërbimit përgjigjet për dëmin që i shkakton nxënësit për shkak të moszbatimit të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve që kanë të bëjnë me organizimin e udhëtimit, sigurinë dhe konformitetin e dëshiruar, që kërkohet për realizimin e kontratës.
- 5.3. Kryesi i Shërbimit nuk ka të drejtë, në asnjë rrethanë, t'u besoj personave të tretë kryerjen e shërbimeve të kontraktuara, përveç personave që janë dëshmuar të kualifikuar, me dokumentacion si në Dosjen e Tenderit.

Neni 6.

- 6.1. Porositësi do të emëroi Menaxherin e Kontratës me detyrën që t'i ndërmerr gjitha masat, procedurat dhe aktivitetet e punës dhe të mbikëqyrjes, të nevojshme – domosdoshme, për të azhuruar, mundësuar dhe siguruar, në bashkëpunim me organet relevante të Njesisë së Kërkesës, që dispozitat e kontratës të përmbushen në kohë nga Kryesi i Shërbimeve, dhe që të drejtat e Autoritetit Kontraktues të përcaktuara në kontratë dhe / ose që lidhen me kontratën të ushtrohen sipas nevojës dhe në pajtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, për të mbrojtur interesin e Autoritetit Kontraktues.
- 6.2. Kontraktuesit pajtohen që Porositësi ta paguaj shumën – çmimin si në nenin dy të kontratës, në bazë të faturës, në konto të Shërbyesit, në afatin prej 28 ditësh nga dita e konfirmimit nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues se shërbimet janë kryer në cilësi dhe konformë dispozitave ligjore dhe kontraktuese.

Neni 7.

- 7.1. Kontraktuesit pajtohen se janë të një mendimi për rregullat e kësaj kontrate, andaj heqin dorë zgjedhja e njëanshme e sajë.

Neni 8.

- 8.1. Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë gjykata kompetente sipas ligjit, ndërsa për bazë do të merren dispozitat si në dosjen për Kuotim të çmimeve me nr. ref. VU644 - 25 - 039 - 211

Neni 9.

- 9.1. Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) Origjinale nga të cilat 3(tri) Origjinale për Porositësin dhe 1(një) Original për Kryesin e Shërbimit.

K O N T R A K T U E S I T:

Për Kryesin e shërbimit,

Hashim Miftari



Për Porositësin,

Ilmi Azemi



Numri i prokurimit: VU644-21-4776-2-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-21-071-211 Titulli: Transporti i nxënësve në relacionet sipas LOT-1 deri LOT-34

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonën E me çmimin për njësi, Çmimi duhet të shkruhet me dy decimalle presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve / Relacionit	Njësia Matëse	Sasia Indikative për 10 muaj	Çmimi DDP - €	Totali -€
1	Lot-36 Sipas Aneksit nr.1 të dosja e tenderit	Ditë pune	185.00	62.00	11,470.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM :					11,470.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	Hashim Miftari B.I.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Hashim Miftari
NËNSHKRIMI:	
DATA:	24.07.2025
VULA:	